

## POZICION VAKANT

**Balkan Finance Investment Group**, BALFIN Group, është një nga grupet investuese më të rëndësishme dhe më të suksesshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Gjeografikisht, Grupi BALFIN është i pranishëm në Austri, Shqipëri, Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe Holandë, me afërsisht 6,000 punonjës në total. Aktivitetet e Grupit BALFIN përfshijnë zhvillimin dhe menaxhimin e pasurive të patundshme, shitjet me pakicë, industrinë minerare, sistemin bankar, turizmin, energjinë, logjistikën, etj. Grupi BALFIN po rritet në mënyrë të qëndrueshme dhe kontribuon në përmirësimin e jetesës së komuniteteve përmes zhvillimit ekonomik, prezantimit të ideve të reja, punësimit dhe investimeve sociale.

Kompania **Mane TCI**, pjesë e Grupit BALFIN, është lider në ndërtim dhe investim të projekteve zhvilluese, në Shqipëri dhe rajon. E themeluar në vitin 2001, Mane TCI është e specializuar në fushën e ndërtimeve civile dhe industriale, si: Qendra Tregtare, Godina Rezidenciale, Qendra Sociale dhe Kulturore, ndërtime industriale dhe infrastrukturë.

**Pozicioni:** Inxhinier Kantieri

**Departamenti:** Teknik

**Vendndodhja:** Palasë/ Vlorë

**Përmbledhja e Pozicionit:** Inxhinieri i Kantierit zbaton direktivat e Drejtuesit të Kantierit dhe kontrollon punimet në përputhje me projektin, specifikimet teknike dhe KTZ, legjislacionit të aplikueshëm në fuqi, kushteve të sigurisë dhe shëndetit në punë.

### Detyrat dhe Përgjegjësitë Kryesore:

- Kontrollon përputhshmërinë e projekteve dhe detajeve (Identifikimin e mospërputhjeve mes projekteve arkitektonike – konstruktive – KUZ – KUB, infrastrukturës inxhinierike nëntokësore), përfshirë rishikimin e detajeve dhe dhënien e zgjidhjeve teknike për zbatim, si edhe detajimin konstruktiv e arkitektonik të elementeve të ndryshëm;
- Harton dhe ndjek grafikun e punimeve sipas projektit dhe planit të organizimit;
- Përpilon dhe kontrollon të gjithë dokumentacionin tekniko-ligjor në objekt, si procesverbale, libreza masash, situacione, akte piketimi e kontrolli, etj;
- Kontrollon cilësinë dhe çështjet e sigurisë në kantier, sigurohet që të gjitha rregullat po zbatohen sipas rregullores të menaxhimit QA/QC dhe HSE, si dhe të rregullave në fuqi;
- Ndjek përmbushjen e kontratave dhe kontrollon firmat nënkontraktore në lidhje me cilësinë e punimeve, situacionet dhe afatin;
- Merr masa për të përmbushur kërkesat ligjore për sigurimin teknik në kantier;
- Ndjek cilësinë e lëndëve të para që vijnë në kantier nga furnitorët e ndryshëm;
- Aprovon materialet që implementohen në kantier;
- Siguron zbatimin e punimeve në përputhje me politikën e menaxhimit të cilësisë së kompanisë;
- Merr në dorëzim punimet e zbatimit si dhe kryen inspektimet e rregullta;
- Përgatit snag listat ose punimet me mangësi apo të papërfunduara si pjesë e procesit të kolaudimit;
- Zbaton me rigorozitet kontratat e sipërmarrjes;
- Zbaton me rigorozitet rregullat teknike dhe kodin e veshjes;

- Përgatit dosjen e cilësisë për materialet specifike të importit që nuk kanë mundësi të analizohen në laboratorët tanë;
- Ndjek zbatimin e cilësisë në procese të ndryshme teknologjike gjatë zbatimit të punimeve;
- Organizon dhe koordinon me stafin në varësi (teknik, brigadier, hidraulik, elektrikist) për punime në kantier;
- Udhëheq punimet, planifikon frontet e punës për procese dhe kontraktorë të ndryshëm, koordinon programin e punës midis kontraktorëve aty ku puna e tyre ndërthuret në faza të caktuara;
- Evidenton nevojat për materiale dhe mirë administrimin e tyre, të makinerive dhe të fuqisë punëtore;
- Përgatit raportet ditore/javore për problematika dhe ecurinë përkatëse;
- Kontrollon periodikisht kostot, në përputhje me preventivin;
- Përgatit draftet e urdhër ndryshimeve dhe shtesave të kontratave;
- Identifikon, planifikon dhe llogarit volumet për zërat e preventivit dhe zërat e punimeve të reja ose të paparashikuara në preventiv.

**Edukimi:** Të zotërojë diplomë universiteti në Inxhinieri Ndërtimi.

**Kualifikime të tjera:**

- Jo më pak se 5 vjet eksperiencë pune në Punime Civile (konstrukcion & rifinitura);
- Aftësi për të lexuar, analizuar dhe shpjeguar projektet, korrespondencat e biznesit, kontratat, procedurat dhe manualët teknike;
- Aftësi për të menaxhuar projekte dhe kontrata të ndryshme specifike që përfshihen në projekte ndërtimi;
- Aftësi për të prezantuar në mënyrë sa më efikase problematikat, komunikim të shkëlqyer verbal dhe me shkrim, përgatitje raportesh, etj;
- Principet dhe praktikat në përdorimin e programeve kompjuterike (CAD, EXCEL, MS-PROJECT (ose PRIMAVERA) etj);

**Mënyra e aplikimit:**

Të gjithë të interesuarit mund të aplikojnë duke dërguar CV-të e tyre dhe letrën e motivimit në [link](#)

**Afati i dorëzimit: 13/07/2022**

*\*Të gjitha aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet të plotë sipas ligjit Nr. 9887 vendosur nga Kuvendi i Shqipërisë për "Mbrojtjen e të Dhënave Personale".*